



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 429/ Prot.

Datë 31.03.2017

Lënda: Mbi kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Konispol

Drejtuar: Z. Shuaip BEQIRI
Kryetar
Bashkia Konispol

I nderuar Z. Beqiri,

Në përgjigje të shkresës Suaj me Nr. 407 Prot., datë 24.03.2017, protokolluar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit me Nr. 429 Prot., datë 27.03.2017 me lëndë “*Kërkesë për lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë të draftit të PPV Bashkia Konispol*”, Ju bëjmë me dijë se:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, pas verifikimit të Regjistrit të Integruar të Territorit konstatoi se, Bashkia Konispol ka botuar vetëm dokumentet e fazës së tretë të PPV (Planin e Zhvillimit dhe Rregulloren), dhe nuk ka bashkëlidhur dokumentet e fazës së parë dhe të dytë (Analizën e Thelluar të Territorit dhe Strategjinë Territoriale). Gjithashtu, mungon edhe materiali në format GIS, për të gjitha fazat.

Për sa më lart, referuar nenit 57 “*Miratimi i PPV-së*”, pika 8, gërma a) të VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, ju bëjmë me dije se nevojitet botimi i plotë i dokumentacionit të PPV Bashkia Konispol, në Regjistrin e Integruar të Territorit, në mënyrë që AKPT të nisë shqyrtimin e dokumenteve të saj dhe në bazë të vlerësimit të lëshojë Aktin e Përputhshmërisë.

Me respekt,

Adelina GRECA

DREJTORE E PËRGJITHSHME



Konceptoi, punoi:
B. Paci, E. Pashollari
Datë: 31.03.2017
Nr. Kopje: 2